

STATUT

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR 20TONI SH.P.K

Neni 1

Emertimi dhe Personaliteti Juridik

- 1.1 Emri i Shoqerise eshte **“20Toni Shpk”**, i ndjekur ne menyre te pandashme nga prapashtesa **“SH.P.K”**, qe perfaqeson formen juridike te saj, te ciles ketu e ne vijim do i referohemi shkurtimisht si **“Shoqeria”**. Dh. 19.05.2020
- 1.2 Shoqeria themelohet dhe kryen aktivitetin e saj si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, te cilit ketej e tutje, do i referohemi shkurtimisht si **“Ligji per Shoqerite”**.
- 1.3 Ortaku ose ortaket e shoqerise (“Ortaket”)- dhe per shmangien e cdo dyshimi, Ortaket fillestare gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne kufirin e kontributeve te tyre perkatese ne kapitalin e perfaqesuar ne kuota.
- 1.4 Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR) ne perputhje me Ligjin Nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”.
- 1.5 Ne dokumenta, fatura, njoftime dhe botime te tjera te nxjerra prej Shoqerise, emri i saj do te paraprihet ose pasohet nga:
- a. Fjalet “Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar” ose “SH.P.K”
 - b. Numri unik i identifikimit (NIPT), si dhe
 - c. Vendndodhjen e selise ligjore dhe/ose te zyres qendrore te saj.

Neni 2

Selia Ligjore

Selia Ligjore e Shoqerise eshte ne Rrugen **“ e Kavajes, Apt. 13 , pallt. 2 Kati i 1-re., Shkall. 3** Shoqeria, me vendim te Asamblese se Ortakeve mund te zhvendose seline e saj ligjore ose te krijojte nje seli operative ne nje vendndodhje tjeter ne Republiken e Shqiperise. Shoqeria mund te



hape dege ose zyra perfaqesimi brenda apo jashte Republikes se Shqiperise, me miratim paraprak me ane te vendimit te Asamblese se Ortakeve.

Neni 3

Kohezgjatja e Shoqerise

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise eshte per nje periudhe te pakufizuar.

Neni 4

Objekti i aktivitetit

4.1 Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e meposhtem :

- Riparim dhe tregtim kepucesh me pakice me porosi.

4.2 Gjithashtu Shoqeria mund te marre pjese ne sipermarrje te tjera, te bleje shoqeri, te krijoje dege brenda dhe jashte vendi, si dhe te ushtroje cdo aktivitet tjeter tregetar per sa kohe qe nuk bie ne kundertshtim me legjislacionin shqipetar.

Neni 5

Ortaket e Shoqerise

5.1 Ortaket, dhe per evitim te cdo dyshimi Themeluesit e Shoqerise jane:

- a. **Z. Eltjon Gjoka** lindur ne Tirane me 10.09.1975 dhe banues ne Tirane, me adrese Rr. Irfan Tomini, pall.12 , apt.5 Tirane., madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar, me dokument identifikimi ID nr. Personal H50910198P.

5.2 Ortaket do te kontribuojne ne kapitalin e Shoqerise dhe si rezultat do te zoterojne pjese (kuota) dhe ushtrojne kontroll ne Shoqeri ne raportet e percaktuara ne nenin me poshte.

Neni 6

Kapitali i Shoqerise dhe Kontributet Perkatese

6.1 Kapitali fillestar i regjistruar i Shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) Leke , pra 1 kuote

6.2 Kapitali i Shoqerise perbehet nga 100.000 (njqind mije) leke me vlere nominale, pra nje kuote. Kontributi ne kapitalin fillestar te regjistruar te Shoqerise behet ne leke.

6.2/1 Anetaret kane kontribuar dhe kane shlyer kapitalin ne para si me poshte :

- ▶ Eltjon Gjoka do te kontriboje ne 100 % te vleres se kapitalit

6.3 Kapitali fillestar i regjistruar eshte nenshkruar dhe shlyer ne teresi perpara regjistrimit te Shoqerise ne QKR, duke depozituar shumen perkatese ne nje llogari te celur ne nje institucion bankar, te licensuar rregullisht per te ushtruar aktivitet bankar ne Republiken e Shqiperise.

6.4 Ortaket kane kontribuar, nenshkruar dhe shlyer perkatesisht si me poshte :

a. **Z. Eltjon Gjoka** lindur ne Tirane me 10.09.1975 dhe banues ne Tirane, me adrese Rr. Irfan Tomini, pall.12 , apt.5 Tirane.,”, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar, me dokument identifikimi ID nr. Personal H50910198P.

6.5 Raporti i Ortakeve Themelues ndaj njeri tjetrit, sic percaktohet ne sektorin 6.4 me siper, nuk do te ndryshohet per asnje arsye, qofte kjo rritje apo zvogelim te kapitalit te Shoqerise, shnderrim apo riorganizim te saj, transferim vullnetar apo jo vullnetar te kuotave apo i te drejtave mbi to tek nje person i trete, apo edhe veprimi apo mosveprimi tjetet, pervecse me miratimin me shkrim te tyre ne perputhje me dispozitat perkatese ne kete Statut.

6.6 Kontributet, nenshkrimet dhe shlyerjet e metejshme te kuotave mund te behen ne para ose ne natyre, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite.

Neni 7

Zmadhimi dhe Zvogelimi i kapitalit

Cdo zmadhim dhe cdo zvogelim i Kapitalit do te vendoset nga Asambleja e Ortakeve ne perputhje me dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

Neni 8

Regjistrimi i Kuotave



- 8.1 Pronesia dhe titulli mbi Kuotat do te rezultojne nga regjistrimi i emrit te Ortakut ne librin e Ortakeve, qe do te mbahet ne seline ligjore te Shoqerise, nen kujdesin e Administratorit /Administratoreve, (sic eshte percaktuar ne Nenin 5, paragrafi 2 me poshte) ("Libri i Ortakeve").
- 8.2 Libri i Ortakeve do te permbaje informacionin e meposhtem:
- (i) numrin e Kuotave te mbajtura nga Ortaket;
 - (ii) daten ne te cilen Ortaku fitoi pronesine;
 - (iii) emrin dhe adresen ose seline ligjore te Ortakut;
 - (iv) vleren nominale te Kuotave te mbajtura; dhe
 - (v) detaje per cdo peng ose barresim mbi Kuotat.
- 8.3 Cdo Ortak ka te drejten te marre, kundrejt nje kerkese me shkrim, nje ekstrakt nga Libri i Ortakeve qe mban vulen e Shoqerise.
- 8.4 Cdo Ortak ka te drejten te verifikojne regjistrimin e tij ne Librin e Ortakeve dhe Administratori/et, ne qofte se eshte kerkuar me shkrim, kane detyrimin t'i sigurojne Ortakut ndihmen e nevojshme.
- 8.5 Te gjitha transferimet e kuotave do te behen ne perputhje me kete statut si dhe Ligjin per Shoqerite ne versionin e tij aktual dhe sic mund te ndryshojne me pas, dhe do te regjistrohen ne Librin e Ortakeve.

Neni 9

Transferimi i Kuotave dhe Kufizimet

- 9.1 Kuotat dhe te drejtat mbi to jane lirisht te transferueshme midis Ortakeve.
- 9.2 Nese njeri nga Ortaket (*Ortaku Shites*) do te transferoje te gjitha apo nje pjese te Kuotave qe ka ne zoterim (*Kuotat ne Shitje*) nje personi te trete, oferten e te cilit ai e ka perzgjedhur si me te kenaqshmen (*Bleresi i Ofruar*), atehere ky Ortak do te njoftoje menjehere Ortaket e tjere (*Njoftimi per Shitje*) per oferten e perzgjedhur si me te kenaqshme per shitjen e kuotave te tij. Ortaket e tjere brenda 30(tridhete) diteve nga dita qe kane marre dijene mbi *Njoftimin per Shitje*, mund te ushtrojne nje nga te drejtat e meposhtme:
- a. Te refuzojne transferimin e Kuotave te *Ortakut Shites* tek *Bleresi i Ofruar*. Ne kete rast Ortaku/et qe ka/ne ushtruar te drejten e refuzimit (parablerjes) (Ortaku/et Refuzues), kane te drejte qe brenda po te njejtit afat 30 (tridhete) ditore t'i bejne/ne *Ortakut Shites* nje oferte per blerjen e *Kuotave ne Shitje*. *Ortaku/et Refuzues* nuk

mund te beje/ne nje oferte te pjesshme, apo te ofroje/ne qe te bleje/ne *Kuotat ne Shitje* per nje cmim blerjeje me te ulet sesa ai i ofruar nga *Bleresi i Ofruar* apo me kushte me te disfavorshme sesa kushtet e ofertes se *Bleresit te Ofruar*. Nese *Ortaku/et Refuzues* nuk ben/bejne oferte per blerjen e *Kuotave ne Shitje* ne kushtet e parashikuara ne kete seksion dhe brenda afatit 60(gjashtedhete) ditor qe nga dita qe ka marre dijeni per *Njoftimin per Shitje*, atehere *Ortaku Shites* ka te drejte qe te shese *Kuotat ne Shitje* cdo personi tjetër me kusht qe kjo shitje te mos behet me cmim me te ulet dhe kushte me te favorshme sesa nga ato te ofruara nga *Bleresi i Ofruar*, perndryshe kjo shitje do te konsiderohej e pavlefshme. Keshtu, per evitim te cdo dyshimi, *Ortaku Shites*, sa here qe do te ofroje per shitje kuotat e tij me cmim apo me kushte me te favorshme sesa ato te njoftuara *Ortakut/eve* tjetër/te tjere, kete oferte per shitje duhet qe t'ia drejtoje me perpara ketij *Ortaku/eve* per t'i dhene mundesine ketij te fundit qe te ushtroje/jne te drejten e tij/tyre te refuzimit fillestar.

b. Te lejoje shitjen e *Kuotave ne Shitje* duke mos zbatuar te drejten e refuzimit (parablerjes).

9.3 Kuotat dhe te drejatat e fituara si rezultat i transferimit nuk mund te ushtrohen ndaj Shoqerise apo personave te trete, perpara se veprimi te jete regjistruar ne Regjistrin Tregetar dhe ne Librin e Ortakeve.

9.4 Asnjeri nga Ortaket nuk ka te drejte qe te krijoje barre, peng apo kufizime te tjera mbi kuotat e tij pa miratimin paraprak me shkrim te Ortakeve te tjere.

VENDIMARRJA DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 10

10.1 Organet e Shoqerise jane :

- a. Asambleja e Ortakeve dhe
- b. Administratori/et

Neni 11

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

11.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te Shoqerise ne perputhje me Ligjin per Shoqerite, vendos ne lidhje me ceshtjet e meposhtme te Shoqerise :



- a. percaktimin e politikave tregtare;
- b. ndryshimin e statutit;
- c. emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d. emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimin e skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te ketij seksioni;
- f. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g. shperndarjen e fitimeve vjetore;
- h. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar;
- i. pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. perfaqesimin e Shoqerise ne gjykimet ndaj administratoreve;
- k. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- l. miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te saj;
- m. ceshtje te tjera te parashikuara shprehimisht nga Ligji per Shoqerite.

Neni 12

Thirrja dhe Menyra e Vendimarrjes se Asamblese se Ortakeve

- 12.1 Mbledhjet e Asamblese se Ortakeve duhet te mbahen ne seline ligjore te Shoqerise ose ne cdo vend tjeter ne Shqiperi ose jashte saj per te cilen kane rene dakort Ortaket Brenda nje kohe te arsyeshme. Gjate Mbledhjes se Ortakeve pergatitet lista e Ortakeve te pranishem dhe te perfaqesuesve te tyre, ku shenohen emrat dhe adresat e secilit, se bashku ne numrin e kuotave, numrin e votave qe keto kuota japin, si dhe vleren nominale te kuotave te zoteruara nga secili pjesemarres. Kjo liste u vihet ne dispozicion Ortakeve dhe perfaqesuesve te tyre dhe nenshkruset prej tyre. Ortaku mund te perfaqesohet ne Mbledhjet e Asamblese se Ortakeve permes nje perfaqesuesi te autorizuar, ne perputhje me dispozitat e nenit 85 te Ligjit per Shoqerite.
- 12.2 Vendimarrja shkresore (pa prezence fizike ne Mbledhjen e Asamblese) ushtrohet permes nenshkrimet te draftit te vendimit/eve me hapesiren perkatese per pranimin apo refuzimin e vendimeve dhe instruksionet e votimit. Ortaku ne varesi te votimit te tij do te vere shenimin ne hapesiren perkatese, do t'a nenshkruaje draft-vendimin perpara nje noteri dhe t'ia ktheje administratorit/eve me poste brenda afatit te caktuar ne njoftim. Ne rast se Ortaku do te



- nenshkruaje vendimin perpara nje noteri jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ky vendim duhet qe te superlegalizohet apo apostilohet ne perputhje me legjislacionin perkates ne varesi te vendimit ku behet nenshkrimi.
- 12.3 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te thirret ne cdo kohe nga Administratori/et apo Ortaku/et qe zoterojne te pakten 5% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise, ne rastet e parashikuara me ligj, njoftimi i cili mund te behet permes administratorit/eve apo ne menytrat e percaktuara nga neni 83 e vijues i Ligjit per Shoqerite.
- 12.4 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te mbaje te pakten nje mbledhje vjetore. Gjithashtu Asambleja e Pergjithshme duhet qe te thirret ne menyre te detyrueshme per rastet e parashikuara ne nenin 82 te Ligjit per Shoqerite.
- 12.5 Asambleja e Pergjithshme mund te thirret permes nje njoftimi me shkrim te vene ne dispozicion te Ortakeve permes dorezimit, faksit apo postes elektronike ne adresat e indikuara ne Librin e Ortakeve. Njoftimi duhet qe te kete arritur tek te gjithe Ortaket, 7 (shtate) dite perpara dites qe duhet te vendoset ne lidhje me ceshtjen e njoftuar.
- 12.6 Administratori/Administratoret duhet t'i pergjigjen, me shkrim, cdo kerkese me shkrim per sqarim per rendin e dites, derguar nga ortaket jo me vone se 4 (kater) dite perpara dates se vendimarrjes se Asamblese se Pergjithshme.
- 12.7 Ne rast se formalitetet per thirrjen, njoftimin dhe menyren e vendimarrjes se Asamblese se Pergjithshme nuk jane respektuar konform ligjit apo statutit, vendimet e marra nga kjo Asamble do te konsiderohen te vlefshme vetem nese njihen shprehimisht si te tilla nga te gjithe Ortaket, unanimisht, me perjashtim te rastit kur ligji nuk e lejon nje rregullim te tille.

Neni 13

Vendimarrja e Asamblese se Ortakeve

- 13.1 Asambleja e Pergjithshme merr vendime pasi te jete krijuar kuorumi i nevojshem, ne baze te pjesemarrjes ne vendimarrje permes prezences (personalisht apo me perfaqesues ne rastin e Mbledhjes se Asamblese), apo pergjigjes me shkrim (vendimarrjes me shkrim), te Ortakeve qe zoterojne jo me pak se 50% te kuotave.
- 13.2 Nese nuk arrihet kuorumi i nevojshem, Asambleja e Pergjithshme mund te thirret te votoje per here te dyte brenda 30 (tridhete) diteve.
- 13.3 Asambleja e Pergjithshme merr vendime me shumice te kualifikuar, qe konsiston ne $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e votave te Ortakeve qe marrin pjese ne vendimarrje, ne rastet e percaktuara ne Ligjin per Shoqerite, perfshire ketu ne lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.



- 13.4 Ne lidhje me ceshtjet e tjera Asambleja e Pergjithshme vendos me shumice te zakonshme, qe konsiston ne shumicen e votave te Ortakeve qe marrin pjese ne vendimarrje.
- 13.5 Pavaresisht nga sa me siper, vendimet qe percaktojne detyrime shtese mbi Ortaket apo vendimet, qe kufizojne te drejtat e tyre, duhet qe te miratohen nga Ortaku perkates, perndryshe keto vendime nuk jane te vlefshme.
- 13.6 Asambleja e Pergjithshme do te votoje duke respektuar parashikimet, kufizimet dhe perjashtimet e percaktuara ne nenet 86-89 te Ligjit per Shoqerite.
- 13.7 Jane te pavlefshme dispozitat e statutit apo vendimet e Asamblese se Pergjithshme te cilat cenojne, kufizojne, apo perjashtojne nje nga te drejtat e Ortakeve ose te kreditorëve te parashikuara ne Ligjin per Shoqerite.
- 13.8 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet te regjistrohen ne perputhje me nenin 90 te Ligjit per Shoqerite.

Neni 14

Administratoret

- 14.1 Asambleja e Ortakeve mund te emeruje nje apo disa administratore per nje afat 5 (pese) vjecar, sic e gjykon te nevojshem per ushtrimin e funksioneve te tij ne perputhje me kriteret dhe duke respektuar kufizimet e parashikuara ne nenin 95 e vijues te Ligjit per Shoqerite.
- 14.2 Administratori/Administratoret i nenshtrohen kriterëve, parimeve, parashikimeve, kufizimeve, perjashtimeve dhe pergjegjesive te percaktuara ne Ligjin per Shoqerite dhe kryesisht atyre te percaktuara ne nenet e Kreut II te Ligjit per Shoqerite, nenin 95, 96 dhe 98.
- 14.3 Administratori i pare i Shoqerise i emeruar per 5 (pese) vjet do te jete **Z. Elton Gjoka**.
- 14.4 Pavaresisht se Administratori i pare eshte caktuar me statut nga Ortaket themelues, shkarkimi, zevendesimi, riemerimi apo cdo veprim tjetër ne lidhje me kete Administrator apo administratoret e tjere do te behet nga Asambleja e Ortakeve ne perputhje me nenin 11 te ketij Statuti.

Neni 15

Kompetencat e Administratorit

- 15.1 Administratori ka kompetencat e meposhtme:



- (i) te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise se Shoqerise;
- (ii) te perfaqesoje Shoqerine;
- (iii) te kujdeset per mbajtejen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te Shoqerise;
- (iv) te pergatise dhe te nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, i cili i paraqet Asamblese se Ortakeve per miratim, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- (v) te krijojte nje sistem monitorimi e njoftimi te hershem per rrethanat, qe kercenojne ekzistencen e shoqerise;
- (vi) te kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas parashikimeve te ketij ligji apo te ligjeve te tjera;
- (vii) te raportoje perpara Asamblese se Ortakeve per zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rendesi te vecante, per veprimtarine e Shoqerise;
- (viii) te kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne ligj dhe ne Statut.

15.2 Administratoret jane te detyruar te ushtrojne kompetencat e tyre si dhe te gjitha aktivitetet e Shoqerise ne perputhje me ligjin, kete Statut si dhe vendimet e Ortakeve. Transaksionet dhe veprimet e meposhtme kerkojne miratimin e Asamblese se Ortakeve e cila do te vendose me shumice prej 2/3 (dy te tretash) te kuotave :

- a. Nenshkrimi, ndryshimi apo zgjidhja e perfundimi i kontratave dhe marreveshjeve me ortaket apo shoqeri te lidhura me Ortaket;
- b. Blerja, zgjerimi i pjesemarrjes apo barresimi i shoqerive apo pjesemarrjeve ne shoqeri;
- c. Marrja e kredive;
- d. Blerja, zgjerimi i pjesemarrjes apo barresimi i pasurive te paluajtshme apo i te drejtave mbi pasurine e paluajtshme;
- e. Marrja dhe akordimi i dorezanive, garancive apo pergjegjesive te ngjashme, si dhe marrja persiper e masave apo mjeteve te sigurimit te pergjegjesive te Shoqerise apo te shoqerive te lidhura;
- f. Marrja dhe akordimi i dorezanive, garancive apo pergjegjesive te ngjashme, si dhe marrja persiper e masave apo mjeteve te sigurimit te pergjegjesive te personave te trete;
- g. Nenshkrimi i kontratave dhe marreveshjeve te qirase, perdorimit apo leasing-ut me afat mbi 5(pese) vjet.



- h. Krijimi dhe themelimi e operimi i degeve dhe filialeve;
- i. Rritja e shperblimeve (pagave) te administratoreve, miratimi i pjesemarrjeve ne rezultatet (fitimin) e Shoqerise apo miratimi e akordimi i benefiteve te vecanta te ngjashme te Administratoreve apo stafit drejtues, si dhe miratimi i pensioneve suplementare te cdo lloji;
- j. Implementimi apo ndryshimi i sistemeve te benefiteve per te gjithë punemarresit apo punemarrs te vecante te Shoqerise apo i sistemeve te pjesemarrjes ne fitim;
- k. Caktimi dhe miratimi i planifikimeve vjetore apo disa-vjetore, si dhe ndryshimi i ketyre planeve apo masave te shoqerise te cilat devijojne nga planet e miratuara, apo ndryshojne ne menyre te konsiderueshme rezultatin ekonomik.

15.3 Vendimet dhe transaksionet e paraqitura ne Nenet 73, 76, 80, 81, 99, 101, 102, 215, 227, dhe 228 te Ligjit Nr.9901 date 14 Prill 2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ne dispozita te tjera ligjore dhe ne Nenin 1 paragrafi 4 te ketij Statuti kerkojne miratimin paraprak te Ortakeve me vendim.

Neni 16

Eksperti Kontabel i Autorizuar

- 16.1 Mbledhja e Asamblese se zakonshme te Ortakeve cakton ekspertin kontabel te Shoqerise.
- 16.2 Eksperti kontabel eshte ne kete detyre per nje mandat 1(nje) vjecar, ne perputhje me vitin fiskal te Shoqerise, me te drejte ri-emerimi.


Neni 17

Viti Fiskal

Viti fiskal i Shoqerise fillon me 1(nje) Janar dhe perfundon me 31 (tridhjetë e nje) Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mbyllet me 31 (tridhjetë e nje) Dhjetor.

Neni 18


Dispozita te Ndryshme



- 18.1 Ky Statut mund te shtohet, ndryshohet ose te zevendesohet me nje Statut te ri, me vendim te Asamblese se Ortakeve te marre me shumice te kualifikuar.
- 18.2 Riorganizimi apo prishja e Shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat e Ligjit per Shoqerite.
- 18.3 Ortaket dhe administratoret do te ushtrojne kompetencat e tyre ne perputhje me parimet e Ligjit per Shoqerite dhe ne vecanti duke respektuar detyrimin per besnikeri.
- 18.4 Shoqeria ne raportin e ecurise se veprimtarise dhe pasqyrat financiare vjetore duhet te perfshije nje document shpjegues, ku trajtohen e shpjegohen parimet e rregullat e mireadministrimit dhe te drejtimit te brendshem te Shoqerise dhe praktikat qe ndiqen prej saj, ne zbatim te dispozitave te Ligjit per Shoqerite dhe ligjeve te tjera te aplikueshme.
- 18.5 Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjate vitit financiar paraardhes, duke zbritur shpenzimet, Shoqeria do te kaloje ne rezerven ligjore, te pakten 5% (pese perqind) te kesaj vlere, derisa kjo reserve te jete e barabarte me 10% (dhjete perqind) te kapitalit te regjistruar te Shoqerise.
- 18.6 Te gjitha ceshtjet qe nuk jane rregulluar shprehimisht ne kete Statut, i nenshtrohen rregullimit nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite, ne versionin e tij actual, dispozitat e Kodit Civil dhe cdo lloj te aplikueshem te Republikes se Shqiperise.
- 18.7 Cdo dhe te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga Gjykata kompetente per ceshtjet tregtare ne seline ligjore te Shoqerise.

Ortaket :

Z. Eltjon GJoka



d